

V E N D I M
Nr. 559, datë 7.11.2002

**PËR MIRATIMIN E LEJES SË FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR,
JOPUBLIK “AMARO TAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes së funksionimit të institucionit arsimor, jopublik fetar “Amaro Tan”, të nivelit parashkollor, kopësht dhe shkollë, të ciklit të ulët 8-vjeçar, klasa I-IV, në qytetin e Pogradecit.
 2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për të përcaktuar modalitetet e funksionimit të këtij insitucioni arsimor, jopublik, dhe për të ndjekur zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore për arsimimin, edukimin, formimin dhe kualifikimin në këtë institucion.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano